



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**

**VENDIM**

Nr.78, datë 18.06.2024

**PËR**

**“CAKTIMIN E ZONJËS ARMIDA KAÇI NË DETYRËN E PROKURORIT  
NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË  
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM SARANDË, NËPËRMJET  
PROCEDURËS SË LËVIZJES PARALELE”**

Mbështetur në nenin 149/a të Kushtetutës, nenin 90, pika 2 të “Kodit të Procedurave Administrative”, nenin 41 dhe 43 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164, pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenin 44 dhe 45 të Rregullores “Mbi transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele” e ndryshuar, si dhe në relacionin shpjegues të paraqitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

**V E N D O S I:**

1. Caktimin e zonjës Armida Kaçi në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, në pozicionin vakant shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë Nr.13, datë 16.02.2024.
2. Marrëdhëniet financiare që lidhen me pagën dhe përfitimet e tjera do të përballohen nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë duke filluar nga data 02.09.2024.
3. Relacioni i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Të njoftohen për këtë vendim prokurorja Armida Kaçi, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.
5. Ky vendim hyn në fuqi më 18.06.2024 dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
6. U shpall në Tiranë, sot më 18.06.2024.

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**

**KRYETAR**

**Mirela Bogdani**



**ANËTAR**

**Sokol Stojani**

**ANËTAR**  
**Zeqir Hoda**

**ANËTAR**  
**Vatë Staka**

**ANËTAR**  
**Ledina Riza**

**ANËTAR**  
**Olger Eminaj**

**ANËTAR**  
**Moisi Duda**

**ANËTAR**  
**Moisi Duda**